

V E N D I M N r 7
I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË
``ERGI`` sh.p.k

Sot, në **Elbasan**, me datën **05 Dhjetor 2022**, u mbledh në selinë e saj në adresën: Autostrada Elbasan-Metalurgji km.3, numri i pasurisë 328/6-NDI, zona kadastrale nr.8526, lagjja 28 Nentori, Rajoni nr.3, - **Elbasan**, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë `` **ERGI** `` **sh.p.k.** sipas lajmërimit të bërë rregullisht për të shqyrtuar problemin e **zmadhimit** të kapitalit të shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë `` **ERGI** `` **sh.p.k.** *nip: K 02727229 P*) ne lidhje me zmadhimit të kapitalit të shoqërisë , me unanimitet :

V E N D O S I:

1. **Miratimin** e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë,
2. Menyra e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë do të jetë:
 - a. Për fitimin e vitit ushtrimor të vitit **2020** (*pjesërisht*) dhe të pa tërhequr prej ortakëve të shoqërisë sipas pasqyrave financiare të shoqërisë të datës **31.12.2020** {nga **50.150.261** lekë totali i fitimit të vitit 2020, do të perdoret për zmadhimit të kapitalit të shoqërisë vetëm vlera **25.000.000** lekë, diferenca e mbetur **25.150.261** lekë do të shperndahet si dividend}.
 - b. Për fitimin e vitit ushtrimor të vitit **2021** (*pjesërisht*) dhe të pa tërhequr prej ortakëve të shoqërisë sipas pasqyrave financiare të shoqërisë të datës **31.12.2021** {nga **85.638.568** lekë totali i fitimit të vitit 2021 , do të perdoret për zmadhimit të kapitalit të shoqërisë vetëm vlera **60.000.000** lekë, diferenca e mbetur **25.638.568** lekë do të shperndahet si dividend }.
3. Nga **1 (një)** kuotë kapitali që ka pasur shoqëria para këtij procesi zmadhimi, numri i kuotave do të mbetet **1 (një)** kuotë kapitali me vlerën nominale të rritur, të cilat do t'i jepen vetëm ortakut të vtem të shoqërisë (*dhe vetëm atij, pra nuk do të kete nenshkrim kuotash nga persona të tjere jo ortakë*).
4. Vlera nominale e një kuote të kapitalit të shoqërisë nga **290.382.000,00** lekë që ishte para procesit të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë, zmadhohet për **plus 85.000.000** lekë pas procesit të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë. Pas këtij procesi zmadhimi, vlera e një kuote të kapitalit të shoqërisë arrin vlerën **375.382.000,00** lekë.
5. Kapitali i shoqërisë nga **290.382.000,00 Lekë** që ishte para procesit të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë, zmadhohet për **plus 85.000.000** leke pas procesit të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë. Pas këtij procesi zmadhimi, **vlera e kapitalit** të shoqërisë bëhet **375.382.000,00 Lekë**, i cili përbëhet nga:

Vlera e kapitalit në Para:	375.382.000,00 Lekë,
Vlera e kapitalit në Natyrë:	0 Lekë.
6. Pas **perfundimit** të procesit të **zmadhimit** të kapitalit të shoqërisë `` **ERGI** `` **sh.p.k.** rezulton si me poshte:
Kapitali i shoqërisë bëhet **375.382.000,00 Lekë**. **Kapitali** i shoqërisë është i ndare në **1 (një)** kuotë kapitali .Kapitali dhe kuotat e shoqërisë zotërohen si me poshte:

a. **z. Nuri Balla**, numri i kuotave të zotëruara **1 (një)** kuotë kapitali, ose **100 %** e kapitalit të shoqërisë e barabartë me **375.382.000,00 Lekë** te vlerës së kapitalit. Vlera e një kuote të kapitalit të shoqërisë ka vlerën **375.382.000,00 Lekë**.

7. Depozitimin e akteve në Qendrën Kombëtare të Biznesit nga **z. Ergi Balla** administratori i shoqërisë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË `` ERGI `` sh.p.k.



Nuri Balla

